



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:259716  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05874294

KPPP.nr.2000/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Shkriortja 1 O.P., me seli në Janjevë, Komuna e Lipjanit, me NUI: 810379108, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Egzona Gashi me seli të zyrës në Lipjan, kundër debitorit BM Group Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Shkupi” BLL.E5, OB.A, Linda Premium Residence L9, me NUI: 810839251, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.299/23 të datës 08.11.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Eset Murati me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 26.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit BM Group Sh.P.K., me seli në Prishtinë, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.299/23 i datës 08.11.2023, i Përmbartuesit Privat Eset Murati, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,000.00 Euro.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit BM Group Sh.P.K., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.299/23 të datës 08.11.2023, të Përmbartuesit Privat Eset Murati, sa i përket shumës prej 14,319.40 Euro së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.

- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Shkëritorja 1 O.P., ndaj debitorit BM Group Sh.P.K., sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.299/23 të datës 08.11.2023, për shumën prej 2,000.00 Euro.
- IV. Detyrohet debitori t'ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 208.00 Euro, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

### A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhërin Përmbartimor P.nr.299/23 të datës 08.11.2023, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: Faturës nr.127/23 të datës 20.06.2023 dhe Faturës nr.210/23 të datës 22.09.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit borxhin sipas faturave të lartcekura në shumën e përgjithshme prej 16,319.40 Euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e arritjes për pagesë për secilën faturë e deri në përmbushjen e urdhërit për përmbartim, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhërit, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhërin, me arsyetimin se obligimet e debitorit ndaj kreditorit nuk paraqesin gjendjen reale, për faktin se fatura me nr.210/23 në vlerë prej 4,814.40 Euro, nuk figuron askund në kartelën e debitorit. Më tej ka theksuar se kartelat nuk janë të barazuara, si dhe një pagesë e bërë nga debitori nuk është e përfshirë në kartelën e kreditorit, edhe përkundër kërkesës dhe insistimit të debitorit që të barazohen kartelat. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi kundër urdhërit përmbartimor të Përmbartuesit Privat.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka deklaruar se e autorizuar e kreditorit nuk ka qenë e njoftuar nga debitori për përmbushjen e pjesërishtme me datën 02.11.2023 të faturës së datës 20.06.2023 në shumën prej 2,000.00 Euro. Më tej ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sa i përket kërkesës për barazim të borxhit, ngase nga data 22.09.2023 e deri me datën 02.11.2023, nuk ka përmbushur detyrimet e tija në bazë të dy faturave dhe kreditori i ka dërguar kartelën financiare të zbritur shumën prej 2,000.00 Euro për faturën 127/23 të datës 20.06.2023. Sa i përket faturës me nr.210/2023 të datës 22.09.2023 në vlerë prej 4,814.40 Euro, kreditori

konsideron se debitori në prapësim nuk ka provuar se ekzistojnë shkaqet e parapara me nein 71 lidhur me nenin 69 par.4 të LPP-së, që do të ishte bazë juridike për të aprovuar prapësimin e ushtruar, ngase nga kjo faturë vërtetohet se e njejta është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet pjesërisht, ashtuqë të ndryshohet urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat dhe të urdhërohet debitori t'ia paguaj kreditorit shumën e mbetur të papaguar në vlerë prej 14,319.40 Euro. I ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës për përpilim të propozimit për përmbarim, për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së, si dhe shpenzimet tjera të procedurës përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme faturat dhe atë: Faturën nr.127/23 të datës 20.06.2023 në shumën prej 11,505.00 Euro dhe Faturën nr.210/23 të datës 22.09.2023 në shumën prej 4,814.40 Euro, në shumë të përgjithshme prej 16,319.40 Euro, në origjinal, dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke anuluar pjesërisht Urdhrin për lejimin e përmbarimit për pjesën sa i përket faturës Nr.127/23 të datës 20.06.2023, në shumën prej 2,000.00 Euro, duke u bazuar në deklaratimet e debitorit në prapësim, deklaratimet e kreditorit

në përgjigje në prapësim, dhe në dëshminë e transaksionit bankar të bashkangjitur në shkresat e lëndës, me të cilin vërtetohet fakti se nga fatura nr.127/23 e datës 20.06.2023 e cila është në shumën prej 11,505.00 Euro, debitori ka paguar pjesërisht borxhin që rrjedh nga kjo faturë dhe atë shumën prej 2,000.00 Euro.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor për borxhin që rrjedh nga Fatura nr.210/23 e datës 22.09.2023 në shumë prej 4,814.40 Euro, dhe për borxhin e mbetur që rrjedh nga Fatura nr.127/23 e datës 20.06.2023 në shumën prej 9,505.00 Euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 14,319.40 Euro, pasi që këto fatura i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, ngase në secilën nga këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, faturat janë dorëzuar në origjinal, dhe këto fatura janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt fakt ky i cili vërtetohet përmes nënshkrimit të debitorit në këto fatura.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i Përmbaruesit Privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 14,319.40 Euro, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në

shumën prej 208.00 Euro, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2000/23, me datë 26.06.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2023:259716  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05874294